

Data 06.09.2023

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: TIRANAGRO**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

79956000-0; 79950000-8

**VLERA E FONDIT LIMIT: 5,585,516.667 (pesë milion e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë pikë gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

*Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.*

*Neni 82, i LPP "1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik".*

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 8 të DST-së.*

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**a.** Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet përkatësisht 2,234,206.67 (dy milion e dyqind e tridhjetë e katër mijë e dyqind e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:*

$$5,585,516.667 \times 40\% = 2,234,206.67 \text{ lekë pa tvsh}$$

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

b. Kopje të certifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit (**2021, 2022**) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.*

c. Vetëdeklarim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, *nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.*

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).*

*Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1** Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet ose **1,117,103.33 (një milion e njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e tre pikë tridhjetë e tre)** lekë pa tvsh dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik do të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

$$5,585,516.667 \times 20\% = 1,117,103.33 \text{ lekë pa tvsh}$$

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

**2.3.2.** Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, duhet të ketë në dispozicion një staf prej minimumi 10 (dhjetë) punonjës me Kontratë pune/ angazhimi (e vlefshme për periudhën e realizimit të aktivitetit), të cilët do të jenë përgjegjës për mbarëvajtjen teknike, montimin/ çmontimin e pajisjeve teknike të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit.

*Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Shtojcës 9 të DST se disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.*

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Vendosija e këtij kriteri është në proporcion me natyrën e kontratës sepse realizimi i objektit të prokurimit kërkon zhvillimin e disa proceseve të kryerjes së shërbimit referuar edhe preventivit të vënë në dispozicion nga AK sikundër janë transporti i pajisjeve në funksion të projektit, montimi i tyre në vendin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, mbarëvajtja teknike e tyre dhe pas realizimit të projektit edhe çmontimin e tyre dhe largimin nga vendi i aktivitetit.

**2.3.3.** Operatori ekonomik duhet të paraqes deklaratë nga administratori i shoqërisë se merr përsipër transportimin, montimin, mbarëvajtjen teknike, si dhe çmontimin e largimin e pajisjeve pas përfundimit të aktivitetit e të gjitha pajisjeve teknike të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit.

**2.3.4** Për të vërtetuar që operatori ekonomik disponon mjetet dhe pajisjet/ aparaturat teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën sipas zërave të përcaktuar në specifikimet teknike në DST duhet të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm që vërteton se ka në pronësi ose me kontratë qeraje/ akt-marrëveshje, ose cdo akt tjetër juridik (të vlefshme).

*Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Shtojcës 9 të DST se disponon mjetet dhe pajisjet/ aparaturat teknike për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ç, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij **kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.**

*Referuar specifikimeve teknike dhe kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor për realizimin e këtij objekti prokurimi dhe realizimin e proceseve të punës sa me sipër cituar lind e nevojshme edhe disponimi i pajisjeve dhe aparaturave teknike të kërkuara në mënyrë që panairi të rezultojë i suksesshëm.*

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ose ekuivalente të tyre të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

a) ISO 9001 për sistemin menaxhimin e cilësisë;

*Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të mallrave apo punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.*

**Shënim:** OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”

- Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s'kualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të

*Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.*

**Argumentimi:** *Kërkesa më sipër është vendosur në mbështetje të nenit 36, pika 3, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku citohet:*

*“3.Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

*b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*

*c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; 23 ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Nëpërmjet kësaj kërkesë Autoriteti Kontraktor kërkon garantimin e një shërbimi të vijueshëm dhe cilësor për realizimin me sukses të kontratës.*

*Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,*

*... “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”*

*si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:*

*... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”*

*Nisur nga proceset e punes kritike, rendësisë së shërbimeve që sistemi ofron, gjykohet e arsyeshme që operatori ekonomik proceset e punes së tij, ti bazojë në standarde botërore, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në cilësi, shpejtesi, efikasitet dhe të shërbimeve të ofruara, konkretisht:*

#### **a) ISO 9001 për sistemin menaxhimin e cilësisë;**

**Argumentimi:** *ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij. Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë, kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij. Kërkesa për ISO 9001 është një kërkesë e domosdoshme për të realizuar suksesin e kontratës.*

## II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41 pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

*Specifikimet teknike të këtij shërbimi, janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), me qëllim përmbushjen e objektivave të kontratës, qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor si dhe OE të marrë masat në kohën e duhur që të garantojë kapacitetet për përmbushjen me sukses të kontratës sipas kushteve të përcaktuara.*

*Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të materialeve që do të përdoren për realizimin e shërbimit me objekt: TIRANAGRO janë si më poshtë vijon:*

- 1. Stenda me përmasa 2.5mx1mx2m, me profile hekuri, kembezat me trashësi 30x30mm, profilet ansore me trashësi 20x20mm, me banak ekspozimi 2mx0.8m me 15 profile hekuri me trashësi 10x10mm katror masiv;*
- 2. Veshje banakut me kombesat dhe veshje copë të zezë të hollë me përmasa 2mx0.8m;*
- 3. Veshje e sipërme e stendës me banner me ngjyrë të bardhë të padepertueshme nga shiu sipas përmasave 2m gjatësia dhe gjërsia;*
- 4. Veshje e poshtme e stendës me banner të bardhë të padepertueshme nga shiu sipas përmasave anësore 1m gjerësi dhe 1.8m gjatësia dhe përmasat ballore 2m gjatësi dhe 1m gjerësi ;*
- 5. Tavolina me konstrukcion metalik dhe banak plastic;*
- 6. Karrige me bazament te qëndrueshëm;*
- 7. Stage me përmasa 2mx2mx0.3m; Stage me përmasa 4m x 3m x 1m me kapriat alumini për vendosjen e fonisë dhe ndriçimit;*
- 8. Fonia; Sistem i varur fonie - 24 copë, Monitorë skene - 6 copë, Mikrofonat për instrumenta - 16 copë, Mikrofonë valor - 8 copë, Mikrofonat për baterinë - 10 copë, Mikrofonat për foltoren - 2 copë, mixer digjital 72in dhe 24out - 1 copë, Aksesorë - Stativë, Kablla, distributorë energjie;*
- 9. Ndriçim robot Beam 145w - 10 copë, Robot 198w - 10 copë, Robot Wash Led 108w - 16 copë, Prozhektor Led 250w - 4 copë, Prozhektorë 200w profile - 6 copë, mixer ndriçimi - 1 copë, efekte atmosferike (hazer-fazer) - 2 copë*
- 10. Led Wall 12m2 outdoor, me Pixel 4.8mm - dimesioni 500x1000x72mm), rezolucioni (104 gjerësi x 208 lartësi pixels), Peshë/panel 13.5 kg, Fuqia mesatare 360Watt, Fuqia max/m2*

720w me mundësi procesimi 4K

11. Kapriat ndriçues për stage, konstruksion metalik 6mx5m me rrobotë ndriçues
12. Tenda me konstruksion metalik me përmasa 3mx2mx2.2m , kembet me profile ele alumini me trashësi 35x35mm , profilet anësore me trashësi 30x30mm, veshje kashte me përmasa 3mx2m
13. Skelet hekuri për flamuj me pamje në tre anë për vendosjen e banerave në permasat:
  - a. Gjatësia 305 centimetra, gjerësia 63 centimetra
  - b. Gjatësia 205 Centimetra, gjerësia 63 centimetra
  - c. Gjatësia 202 centimetra, gjerësia 63 centimetra
14. Tenda me konstruksion metalik dhe veshje cope ngjyrë jeshile në përmasat 4m me 4m
15. Tenda magazinuese me përmasa 5mx5m, me konstruksion metalik, me mbulesë baneri
16. Baner i loguar me imazhin e panairit me përmasa 200cmx40cm
17. Banneri të loguar me imazhet e panairit për flamujt me përmasat:
  - a. Gjatësia 305 centimetra, gjerësia 63 centimetra
  - b. Gjatësia 205 Centimetra, gjerësia 63 centimetra
  - c. Gjatësia 202 centimetra, gjerësia 63 centimetra
- 18 Autobot Uji 6000Lt
- 19.Tapet jeshil për strukturen e shtepizave të drurit 15m gjerësia dhe 15m gjatësia
- 20.Shtëpiza druri 2mx2m
- 21.Kapëse të zeza për kapjen e bannerit të banakut dhe pjesës së sipërme të stendës sipas përmasave të stendave
- 22.Adeziv I printuar me desing në përmasat 2mx2m për stage
- 23.Kulla ndriçimi, me elevator metalik, me përmasa 6mX 2m, me 6 drita (1000Watt) të bardha/prozhektor, në secilën kullë

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Autoriteti Kontraktor Bashkia Tiranë ka parashikuar të zhvillojë një panair me qëllim orientimin e konsumatorit kryeqytetas drejt njohjes dhe përdorimit të prodhimeve lokale të Tiranës nëpërmjet promovimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale si dhe produkteve artizanale. Organizimi i këtij panairi është planifikuar të zhvillohet gjatë muajit Shtator, në datat 21-22-23-24 Shtator 2023 dhe do të realizohet në një zonë me frekuentueshmëri të lartë, në Sheshi Skënderbej, në të cilin fermerët do të grupohen sipas fushave të prodhimit.

Panairi “TIRANAGRO”, tashmë i kthyer në një traditë e Bashkisë Tiranë ka si qëllim orientimin e konsumatorit kryeqytetas drejt njohjes dhe përdorimit të prodhimeve lokale të Tiranës



nëpërmjet promovimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale si dhe produkteve artizanale.

Projekti do të realizohet nëpërmjet zhvillimit të panairit vjetor, ku do të promovohen produktet bujqësore dhe blegtorale si: produktet bujqësore, vreshtaria, bulmeti, mjalti, frutat e egra, bimët medicinale etj.

Njëkohësisht ky projekt do të mundësojë promovimin e artizanëve dhe prodhimeve të tyre.

Panairi do të realizohet në një zonë me frekuentueshmëri të lartë, në Sheshi Skënderbej, në të cilin fermerët do të grupohen sipas fushave të prodhimit.

Panairi do të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me Njësitë Administrative Rurale, Drejtori të ndryshme brenda Bashkisë Tiranë si dhe shoqatat që operojnë në fushën e bujqësisë, blegtorisë e artizanatit.

Fokusi i panairit do të jetë prezantimi dhe promovimi i produkteve lokale.

*Të gjitha pajisjet referuar preventivit bashkëlidhur dokumentave standarte të tenderit janë të domosdoshme për realizimin me sukses të këtij projekti. Përmasat, specifikat dhe detjaet e këtyre pajisjeve janë përcaktuar dhe miratuar nga ekspertë të fushës (arkitektë) pranë Drejtorisë së Projekteve Strategjike të cilët kanë hartuar projekt idenë si dhe planvendosjen e pajisjeve dhe aparaturave të gjitha këto në funksion të projektit bashkëlidhur dokumentave standarte të tenderit.*

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike/ termat e referencës, dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialisti/ specialistët e fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “TIRANAGRO”, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

- Dokumentat e tenderit.
- Planvendosja Panairi Bujqësor Shtator 2023 “TIRANAGRO”

**Njësia e prokurimit**